



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK

Rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 229 063 • E-mail: juridiku@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dekani
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi

Nr.prot: 01/363
Datë: 26/07/2016

Në bazë të nenit 66, 72 dhe 76 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit Juridik, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016, mori këtë:

V E N D I M

Hyrja në provim sipas ndarjes së listave përmes SEMS

1. Në lëndët që ka më shumë se një mësimdhënës, shpërndarja e studentëve në lista të paraqitur në provim bëhet përmes SEMS me automatizëm në mënyrë proporcionale për secilin mësimdhënës,
2. Obligohen mësimdhënësit e të njëjtës lëndë që të kenë planprogram mësimor të harmonizuar dhe literaturë obligative të njëjtë,
3. Obligohen mësimdhënësit që ti marrin parasysht kollokfiumet e lëndës përkatëse me rastin e vlerësimit të notës përfundimtare, pavarësisht të cili mësimdhënës është mbajtur kollokfiumi. Rezultati i kollokfiumeve shpallet në mënyrë publike,
4. Ky vendim fillon të zbatohet nga afati i Janarit 2017.

Arsyetim

Në zyrën e Dekanit të Fakultetit janë paraqitur kërkesa të vazhdueshme të studentëve për ndërrimin e mësimdhënësit të lëndës për provim. Gjithashtu, ka kërkesa edhe të mësimdhënësve për ndarjen e listave të studentëve në mënyrë proporcionale.

Prandaj, Këshilli i Fakultetit e vlerëson të nevojshme marrjen e këtij vendimi për ndarjen e listave të studentëve në provim në mënyrë proporcionale si dhe harmonizimin e planprogrameve mësimore për të njëjtën lëndë. Më këtë ruhet transparenca, vlerësimi real i studentëve dhe rritet cilësia e studimeve.

Andaj, siç u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i'u dërgohet:

1. Mësimdhënësve,
2. Shërbimit të studentëve të Fakultetit
3. Drejtorit të IT – SEMS,
4. Shpallet në Web faqe të Fakultetit dhe
5. Arkivit të Fakultetit


DEKANI
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi